



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:226229
Datë: 22.12.2023
Numri i dokumentit: 05110892

C.nr.1002/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit A.J.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurit A.B nga fshati Babovc, Komuna e Rahovecit, për shkak të kthimit të borxhit, me datë **13.12.2023**, mori këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit A.J.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi A.J.H, kësaj gjykate i ka ushtruar padi, me datë 06.10.2021, kundër të paditurit A.B nga fshati Babovc, Komuna e Rahovecit, për shkak të kthimit të borxhit.

Në bazë të padisë së paditësit, gjykata ka caktuar seancën përgatitore për datë 13.11.2023 në të cilën ka prezantuar paditësi personalisht mirëpo për të paditurin nga fletëkthesa konstatohet se për të njëjtin ftesën e ka pranuar personi i tretë.

Në seancën e radhës të caktuar nga gjykata për datë 13.12.2023 ka prezantuar i padituri por në të njëjtën nuk ka prezantuar paditësi edhe pse është njoftuar gojarisht me procesverbal ne seancë lidhur me caktimin e seancës dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, andaj kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 423.3 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësit është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.1002/2021, më datë 13.12.2023

Gj y q t a r i
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë – Divizioni Civil.